Mbi dëgjesat publike dhe propozimin për ndryshimin e tarifave volumetrike të ujit dhe kanalizimeve për periudhën 2027–2029

1. Qëllimi i relacionit

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a. (SHRUKD), në kuadër të transparencës institucionale dhe informimit të publikut, zhvilloi gjatë muajit tetor 2026 dëgjesa publike me qytetarët e pesë Njësive Operative: Durrës, Shijak, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, lidhur me propozimin për ndryshimin e tarifave volumetrike të furnizimit me ujë dhe të shërbimit të kanalizimeve.

Dëgjesat publike u zhvilluan sipas këtij kalendari:

- **5 tetor 2026:** Durrës dhe Shijak;
- **8 tetor 2026:** Kavajë dhe Rrogozhinë;
- **9 tetor 2026:** Krujë.

Gjatë takimeve u prezantuan propozimet tarifore të shoqërisë dhe u diskutuan çështje që lidhen me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Qytetarët patën mundësinë të njihen me propozimet dhe të paraqesin mendimet, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre. Materiali integron supozimet kryesore dhe projeksionet financiare që mbështesin si Planin e Biznesit 5-Vjeçar (2027–2031) hartuar në mbështetje të projekti të AFD-së Konsulenca Institucionale, ashtu edhe dosjen e aplikimit për tarifa në përputhje me kërkesat e ERRU-së, e cila duhet të dorëzohet jo më vonë se data 30 nëntor 2026. Propozimi tarifor përfaqëson, për rrjedhojë, një hap kritik drejt përmirësimit të mbulimit të kostove, reduktimit të varësisë nga transfertat dhe forcimit të qëndrueshmërisë afatgjatë, në përputhje të plotë me strategjinë kombëtare të financimit 3T (Taksat–Transfertat–Tarifat) dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare të Ujit dhe Kanalizimeve (SKUK 2022–2030).

Propozimi tarifor për periudhën 2027–2029 për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës (SHRUKD) përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt garantimit të vazhdimësisë së shërbimit, përmirësimit të qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimit gradual të varësisë nga subvencionet publike. Analiza tregon se tarifat aktuale nuk mbulojnë plotësisht kostot operative të shoqërisë, duke rezultuar në një nivel mbulimi prej vetëm 85% në vitin 2025. Pa ndërhyrje tarifore, kjo situatë do të kufizonte aftësinë e shoqërisë për të financuar energjinë elektrike, mirëmbajtjen, personelin dhe aktivitetet e nevojshme operative.

Plani i propozuar është ndërtuar mbi parime konservatore dhe realiste. Ai nuk mbështetet në kursime të supozuara nga investime të ardhshme, nuk parashikon ulje agresive të kostove dhe nuk përfshin rikuperimin e investimeve kapitale. Objektivi i tij është ekskluzivisht mbulimi i kostove operative (OPEX), duke krijuar bazën financiare të nevojshme për funksionimin normal të shoqërisë.

2. Historiku i tarifave

Për Njësitë Operative Durrës dhe Shijak, me vendimin nr. 15, datë 16.05.2024, Enti Rregullator i Ujit (ERRU) ka ndryshuar vetem tarifat e shërbimit, me afat deri më 31.12.2026. Ndryshimi i fundit i tarifave volumetrike të ujit dhe kanalizimeve daton më 01.09.2017.

Për Njësitë Operative Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, ndryshimi i fundit i tarifave nga ERRU-ja është bërë me vendimin e datës 15.06.2024, me afat deri më 31.12.2026.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2026, SHRUKD ka paraqitur propozimet për rishikimin e tarifave sipas Njësive Operative dhe kategorive të abonentëve: familjarë, privatë dhe publikë si një nevojë .

3. Tabelat e tarifave të propozuara

Tabelat e mëposhtme paraqesin vlerat e propozuara nga SHRUKD për vitet 2027, 2028 dhe 2029. Vlerat janë pasqyruar sipas materialit të paraqitur nga shoqëria.

Njësitë Operative Durrës dhe Shijak

Kategoria familjare

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	70	72	74	75
Kanalizime	50	50	50	50
Tarifa fikse	200	300	300	300

Kategoria private

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	140	150	150	150
Kanalizime	70	100	100	100
Tarifa fikse	300	600	600	600

Kategoria publike

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	140	150	150	150
Kanalizime	70	100	100	100
Tarifa fikse	300	600	600	600

Njësia Operative Kavajë

Kategoria familjare

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029

Uji	50	52	55	55
Kanalizime	30	32	35	35
Tarifa fikse	200	300	300	300

Kategoria private

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	140	150	150	150
Kanalizime	50	50	70	70
Tarifa fikse	300	600	600	600

Kategoria publike

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	140	150	150	150
Kanalizime	50	50	70	70
Tarifa fikse	300	600	600	600

Njësitë Operative Krujë dhe Rrogozhinë

Kategoria familjare

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	48	52	55	55
Kanalizime	10	20	22	22
Tarifa fikse	200	300	300	300

Kategoria private

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	100	150	150	150
Kanalizime	20	40	44	44
Tarifa fikse	300	600	600	600

Kategoria publike

Lloji i tarifës	2026	2027	2028	2029
Uji	96	150	150	150
Kanalizime	20	40	44	44
Tarifa fikse	300	600	600	600

Shënim: Vlerat në tabela janë shprehur në lekë/m3, ndërsa tarifa fikse lekë/muaj.

Si rezultat i strategjisë tarifore të propozuar, mbulimi i kostove operative përmirësohet ndjeshëm:

- 85% në vitin 2025
- 102% në vitin 2027
- 105% në vitin 2028
- 108% në vitin 2029

Kjo do të thotë se shoqëria kalon nga një situatë me defiçit operacional në një pozicion ku kostot operative mbulohen plotësisht dhe krijohet një rezervë e moderuar financiare për përballimin e risqeve operative.

Analiza sipas njësive Operative tregon se:

- **Durrësi**, që përfaqëson mbi 75% të aktivitetit të shoqërisë, arrin mbulimin e plotë të kostove operative brenda periudhës tarifore.
- **Kavaja** paraqet potencialin më të lartë të rritjes, e mbështetur nga zhvillimi i fortë turistik dhe zgjerimi i bazës së klientëve.
- **Kruja** mbetet njësia me sfidat më të mëdha financiare për shkak të bazës së kufizuar të klientëve dhe kostove fikse relativisht të larta.
- **Rrogozhina** vazhdon të kontribuojë pozitivisht në ekuilibrin financiar të shoqërisë, ndonëse rezultatet duhet të interpretohen në kuadër të modelit rajonal të alokimit të kostove.

Nga këndvështrimi social, propozimi tarifor mbetet plotësisht i përballueshëm. Edhe pas rritjeve të propozuara, pesha e faturës së ujësjellës-kanalizimeve ndaj të ardhurave familjare mbetet:

- 2.9% në Durrës–Shijak
- 2.1–2.2% në Kavajë
- 1.9–2.0% në Krujë dhe Rrogozhinë

3.1. Tarifimi me blloqe për SHRUKD-në

Referuar nenit 19 të metodologjisë së ERRU-së, do të propozoje tarifimin me blloqe, i cili synon promovimin e përdorimit racional të ujit, mbrojtjen e burimeve ujore dhe reflektimin më të drejtë të kostove operative të shërbimit.
Metodologjia parashikon aplikimin e tarifave volumetrike me nivele të diferencuara konsumi për klientët e pajisur me matës individualë, duke krijuar një mekanizëm që orienton konsumatorët drejt përdorimit më eficient të ujit, veçanërisht gjatë periudhave me konsum të lartë sezonal. ERRU gjithashtu inkurajon operatorët që të propozojnë struktura tarifore me blloqe për të diferencuar konsumin bazë nga konsumi intensiv dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.
Analiza e profileve reale të konsumit për vitin 2025 në Njësinë Operative Durrës si njësia më e madhe e shoqërisë, evidenton qartë një efekt të fortë sezonal, ku rritja e kërkesës për ujë gjatë muajve të verës nuk shpërndahet proporcionalisht tek të gjithë konsumatorët, por përqendrohet tek segmentet me konsum intensiv. Për kategorinë familjare, shumica dërrmuese e abonentëve mbetet në nivele normale konsumi gjatë gjithë vitit, ndërsa vetëm një segment relativisht i vogël klientësh

me konsum mbi 30 m³ gjeneron një pjesë disproporcionale të volumit total dhe të ngarkesës operative mbi sistemin. Për këtë arsye, propozohet që për kategorinë familjare të aplikohet ndarja në dy blloqe:

- 0–30 m³;
- dhe mbi 30 m³.

Kjo qasje shmang ndikimin mbi konsumatorin standard familjar dhe fokuson aplikimin e bllokut të dytë tek segmenti që realisht amplifikon kërkesën gjatë sezonit veror. Analiza e databazës së klientëve tregon se konsumatorët familjarë mbi pragun 30 m³ përfaqësojnë një pjesë relativisht të vogël të totalit të abonentëve, çka e bën këtë prag më të përshtatshëm operacionalisht dhe socialisht krahasuar me kufirin orientues prej 18 m³ të parashikuar në metodologji.

Për kategorinë private dhe institucionale/publike, analiza e profileve të konsumit tregon një strukturë shumë më të përqendruar të volumit tek konsumatorët me përdorim intensiv. Gjatë muajve të verës, segmenti me konsum mbi 300 m³ rezulton të gjenerojë pjesën më të madhe të volumit total dhe të krijojë presionin kryesor operacional mbi sistemin e furnizimit me ujë. Për këtë arsye, propozohet që edhe për kategoritë private dhe publike të aplikohet një strukturë me dy blloqe:

- 0–300 m³;
- dhe mbi 300 m³.

Kjo ndarje konsiderohet më e përshtatshme për të kapur efektin real sezonal dhe për të diferencuar konsumatorët standardë nga konsumatorët me ndikim të lartë operacional. Për kategorinë private dhe publike, sistemi i faturimit mundëson identifikimin e historikut të konsumit për çdo klient dhe krijon bazën teknike për përcaktimin e kufijve të konsumit që do të përdoren në aplikimin e tarifimit me blloqe.
Për familjarët, koeficientët mund të variojnë nga 1.0 në bllokun bazë deri në 3.0 për konsumet më të larta. Për klientët privatë dhe publikë, koeficientët mund të arrijnë deri në 4.0 për konsumet mbi nivelet historike të referencës

Aplikimi i tarifimit me blloqe, duhet parë si një mekanizëm i arsyeshëm dhe i justifikuar për:

- shpërndarjen më racionale të kostove të shërbimit sipas profileve reale të konsumit;
- përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë;
- dhe krijimin e një instrumenti më efektiv për menaxhimin e kërkesës gjatë sezonit veror, kur sistemi përballet me ngarkesën më të lartë operative.

4. Transparenca dhe konsultimi me publikun

Zhvillimi i dëgjesave publike përbën një element të rëndësishëm të transparencës institucionale dhe të konsultimit me abonentët përpara vijimit të procedurave të shqyrtimit të propozimeve tarifore nga institucionet kompetente.

Përmes këtyre takimeve, SHRUKD synon të garantojë informimin e qytetarëve mbi propozimet e paraqitura, të marrë në konsideratë shqetësimet e tyre dhe të nxisë dialogun me komunitetin lidhur me përmirësimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Duke i siguruar se strategjia tarifore arrin gradualisht objektivin e saj kryesor: harmonizimin e të ardhurave me kostot reale të operimit dhe krijimin e kushteve për një qëndrueshmëri financiare afatgjatë të njësisë më të madhe të shoqërisë.

5. Statusi i propozimit

Vlerat e pasqyruara në këtë relacion përfaqësojnë propozimet e paraqitura nga SHRUKD gjatë vitit 2026. Ato nuk përbëjnë tarifa të miratuara përfundimisht. Miratimi dhe zbatimi i tarifave të reja do të kryhen në përputhje me vendimmarrjen e ERRU-së dhe procedurat rregullatore në fuqi.

Relacioni publikohet në kuadër të Programit të Transparencës, me qëllim informimin e publikut mbi procesin e dëgjesave publike dhe propozimet për ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve.